



Breaking News:

⏸ ⏮ ⏭



29/01/2025

Durrës/Ndërhyrja E Policisë Parandalon Përshkallëzimin E Një Konflikti Fizik Ndërmjet 2 Shtetasve

Durrës

Ndërhyrja e Policisë parandalon përshkallëzimin e një konflikti fizik ndërmjet 2 shtetasve, njëri prej të cilëve kanosi tjetrin, me një send në dukje armë zjarri pistoletë.

Vihet në pranga 30-vjeçari që u konfliktua fizikisht me 36-vjeçarin dhe e kanosi atë.

Procedohet penalisht 36-vjeçari.

Shërbimet e Policisë, mbrëmjen e djeshme, pas marrjes së njoftimit se në lagjen nr. 6, një shtetas po konfliktuhej fizikisht me një shtetas tjetër dhe po e kanoste atë me një send në dukje armë zjarri pistoletë që kishte me vete, kanë organizuar menjëherë punën për parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit.

Nga veprimet e shpejta është kapur dhe vënë në pranga shtetasi M. L., 30 vjeç, banues në Durrës, për veprat penale “Kanosja” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive. Ky shtetas është konfliktuar fizikisht me shtetasin D. M., për motive të dobëta.

Në vijim të veprimeve u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi penal për shtetasin D. M., 36 vjeç, banues në Durrës, për veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje” .

Nga veprimet e para në vendin e ngjarjes rezultoi se arma me të cilën 30-vjeçari kishte kanosur 36-vjeçarin, ishte armë sportive. Arma u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.



Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ DVP Elbasan/Finalizohet operacioni policor i koduar “Fictitious”

Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, gjatë 24 orëve të fundit ▶